

# GAP INDEKSI I TRANSPARENCËS BUXHETORE TË KOMUNAVE 2017

## Hyrje

Transparenca e plotë buxhetore për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e organizatave buxhetore të Republikës së Kosovës është një nga parakushtet kryesore për llogaridhënie dhe njëra nga mënyrat për të parandaluar keqmenaxhimin me paranë publike. Rritja e transparencës buxhetore gjithashtu ndikon në përfshirjen e qytetarëve në procesin buxhetor dhe mund të ndikojë në rritjen e të hyrave komunale.<sup>1</sup> Qëllimi i kësaj analize është vlerësimi i legjislacionit dhe gjendjes reale sa i përket transparencës buxhetore në nivelin lokal. Për këtë qëllim kemi hartuar një indeks të transparencës buxhetore komunale në bazë të së cilit i kemi renditur komunat varësisht nga numri i dokumenteve të publikuara, dëgjimeve buxhetore me qytetarë dhe përgjigjet në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumente buxhetore. Përveç vlerësimit të transparencës buxhetore, kjo analizë përfshin të dhënat nga një anketë e realizuar me qytetarë lidhur me njohuritë e tyre sa i përket buxhetit lokal.

Në bazë të të gjeturave të kësaj analize, ligjet e Republikës së Kosovës ofrojnë një bazë të mirë sa i përket transparencës buxhetore në nivel lokal, mirëpo kjo bazë ligjore duhet avancuar. Problem mbetet respektimi i obligimeve ligjore për publikimin e dokumenteve, si dhe qasja në dokumente buxhetore përmes kërkesave. Rezultatet e indeksit tregojnë një nivel mesatar të transparencës buxhetore të komunave. Shqetësues mbetet fakti se mbi gjysma e komunave nuk kanë publikuar në ueb-faqet e tyre të gjitha raportet buxhetore, ose nuk janë përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP për qasje në një apo më shumë dokumente buxhetore të cilat janë të obliguara t'i publikojnë.

Problem tjetër është edhe niveli i ulët i njohurive të qytetarëve sa i përket proceseve buxhetore lokale dhe pjesëmarrja e ulët në debatet për buxhet. Shumica e qytetarëve nuk kanë marr pjesë në asnjë tubim publik të organizuar nga komuna në 12 muajt e fundit, ndërsa gjysma nuk janë të informuar se

---

<sup>1</sup> Banka Botërore, "Budget Transparency: What, Why, and How?", Burimi: <http://bit.ly/2hFNJ6N>

komuna ka obligim të organizojë dëgjime publike me qytetarë sa i përket buxhetit. Arsye për mospjesëmarrjen e qytetarëve në debate publike mbetet besimi i ulët se institucionet do të veprojnë sipas kërkesave, si dhe mungesa e një komunikimi efektiv me qytetarë nga ana e komunave.

Kjo analizë përveç vlerësimit të bazës ligjore dhe zbatimit të saj në praktikë, ofron një sërë rekomandimesh sa i përket përmirësimit të nivelit të transparencës buxhetore në komuna.

## Metodologjia

Për të standardizuar vlerësimin e transparencës buxhetore në komuna, Instituti GAP ka hartuar një indeks prej 100 pikëve sa i përket publikimit të dokumenteve dhe organizimit të dëgjimeve buxhetore. Numri i pikëve për një dokument është i njëjtë për të gjitha komunat dhe këto pikë janë vendosur sipas gjykimit të Instituti GAP duke u bazuar në peshën që kanë këto dokumente në rritjen e transparencës buxhetore. Për shembull, krahasuar me dokumentet tjera të përfshira në indeks, "Kartela Analitike e Kontos" është vlerësuar me më së shumti pikë, ngase është dokumenti më i detajuar sa i përket buxhetit të komunës.

**TABELA 1:** VLERËSIMI ME PIKË I KOMUNAVE PËR PUBLIKIMIN E DOKUMENTEVE SIPAS GAP-IT

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	Sknuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	3.5	2.5	1.5
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	15	10.5	7.5	4.5
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	3.5	2.5	1.5
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	10	7	5	3
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	5	5	1.5
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	10	7	5	5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime buxhetore për 2016	20	14	10	10
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	5	5	5
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	5	5	5
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	5	5	5
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	5	5	5
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>67.5</b>	<b>52.5</b>	<b>50</b>

Përveç rregullores për ndarjen e subvencioneve, të gjitha dokumentet e publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri, siç është Microsoft Excel, janë vlerësuar me maksimumin e pikëve. Dokumentet e publikuara në formatin PDF janë vlerësuar me 30% pikë më pak, ndërsa publikimi i dokumenteve të skanuara është vlerësuar me 50% më pak pikë. Në rast se një dokument nuk është publikuar fare në faqen zyrtare të komunës, mirëpo komuna është përgjigjur në kërkesën tonë, atëherë kjo është vlerësuar me 70% më pak pikë. Përfundim në uljen e pikëve prej 70% për dokumentet e dërguara me kërkesë bëjnë Kartela Analitike e Kontos dhe lista e përfituesve të subvencioneve – kjo për shkak që këto nuk janë ende obligime ligjore të përcaktuara sipas Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Gjithashtu, duke qenë se ky indeks nuk bën vlerësimin e cilësisë së dokumenteve të publikuara, edhe nëse Kartela Analitike e Kontos nuk është publikuar e plotë, i kemi dhënë pikë maksimale në rast se ajo është publikuar në formatin excel. Pra, një komunë mund të merr maksimumin e pikëve vetëm në rast se i ka publikuar të gjitha dokumentet në faqen e internetit në formatin Excel dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore.

Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat që të plotësojnë një dokument me linqet/vegzat e dokumenteve të publikuara në faqen e komunës. Kërkesa është dërguar në emailin zyrtar të komunës për komunikim me publikun në muajin gusht, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave nga Instituti GAP ka përfunduar në muajin korrik. Katër komuna kanë ofruar dëshmi se për shkak të problemeve në MAPL, nuk ka funksionuar faqja zyrtare e internetit.<sup>2</sup> Për këtë arsye këto katër komuna janë larguar nga vlerësimi dhe nuk radhiten në indeksin e transparencës buxhetore. Për komunat të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesën tonë, vlerësimi i indeksit është bërë në bazë të informatave që kemi mundur t'i gjejmë në ueb-faqet e tyre. Në parim, në rast se një dokument nuk gjendet në faqen e komunës pas tri klikimeve, atëherë nuk është marrë parasysh në vlerësim.

## Baza ligjore për transparencë buxhetore komunale

E drejta e qytetarëve për qasje në dokumente publike garantohet me Kushtetutën e Kosovës. Sipas Kushtetutës, dokumentet që mbajnë institucionet shtetërore duhet të jenë publike, me përjashtim të informatave sekrete, informatave të klasifikuara të sigurisë dhe ato që cenojnë privatësinë.<sup>3</sup> Përveç Kushtetutës, Ligji për qasje në dokumente publike rregullon më në detaje çështjen e kërkesave të personave fizik dhe juridik për qasje në informata apo dokumente publike.<sup>4</sup> Të gjitha institucionet publike duhet të kenë faqe zyrtare të internetit, të përditësuara me informata të sakta dhe të cilat janë lehtë të qasshme nga publiku.<sup>5</sup>

Sipas Udhëzimit administrativ të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) për transparencë në komuna, të gjitha dokumentet e kuvendit të komunës bëhen të qasshme për publikun, duke përfshirë publikimin në ueb-faqen zyrtare.<sup>6</sup> Sa i përket buxhetit, komunat kanë për detyrë t'i publikojnë këto dokumente: 1) planin e buxhetit dhe planet investuese; 2) raportet tre mujore të shpenzimeve; 3) kornizën afatmesme buxhetore (KAB); 4) raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal; dhe 5) raportin e auditorit të përgjithshëm mbi buxhetin për vitin e kaluar fiskal. Me qëllim të lehtësimit të gjetjes së informatës nga qytetarët, vegëzat e dokumenteve të publikuara në ueb-faqen e komunave duhet të vendosen në bazë të fushave.<sup>7</sup> Ligji për

<sup>2</sup> Këto komuna janë: Gjakova, Hani i Elezit, Ferizaj dhe Klina

<sup>3</sup> Kushtetuta e Kosovës, Neni 41, Burimi: <http://bit.ly/2xmK8jm>

<sup>4</sup> Ligji nr. 03/I-215 për qasje në dokumente publike, Burimi: <http://bit.ly/2xmsnkb>

<sup>5</sup> Ministria e Administratës Publike, Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike, Burimi: <http://bit.ly/2fkëkfc>

<sup>6</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Neni 4, Burimi: <http://bit.ly/2fkëkfc>

<sup>7</sup> Ibid, neni 12

Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), i bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve tre-mujore financiare të cilat duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.<sup>8</sup>

Në asnjërin nga ligjet që rregullojnë financat publike, nuk përmendet se duhet të hartohet dhe publikohet buxheti për qytetarë. Kjo formë e thjeshtëzuar e publikimit të buxhetit bëhet me qëllim që qytetarët të kuptojnë më lehtë buxhetin dhe kështu të rritet përfshirja e tyre në proceset buxhetore.<sup>9</sup>

Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kuvendi i komunës nxjerr rregullore komunale që e rrisin transparencën duke e nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në marrjen e vendimeve dhe gjithashtu për të siguruar qasje në dokumente zyrtare. Gjithashtu, sipas të njëjtit ligj, çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç dokumenteve që ndalohen me Ligjin për qasje në dokumente zyrtare.<sup>10</sup>

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, kuvendi komunal është i detyruar të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë, në përputhje me aktet komunale.<sup>11</sup> Udhëzimi administrativ i MAPL-së për transparencë në komuna përcakton se komunat përveç obligimit që t'i mbajnë të paktën dy dëgjime publike me qytetarë brenda vitit, duhet të organizojnë takime publike shitesë për buxhet dhe çështje tjera komunale.<sup>12</sup> Kërkesat nga këto takime duhet të evidentohen nga kuvendi i komunës brenda 15 ditëve.

Gjatë përgatitjes së buxhetit komunal, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nuk e detyron kryetarin e komunës që të mbajë dëgjime publike. Mirëpo, në disa raste qarkoret buxhetore të hartuara nga Ministria e Financave (MF) e obligojnë kryetarin e komunës që të shqyrtojë buxhetin me qytetarë. Në qarkoren buxhetore për komuna lidhur me buxhetin e vitit 2016, MF ka kërkuar specifikisht këto tri organe brenda komunës të organizojnë takime buxhetore publike: a) Komiteti i Kuvendit Komunal për Politikë dhe; 2) Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar së bashku me drejtoritë tjera të komunës; dhe 3) Kuvendi Komunal.

Përveç obligimeve për publikimin e këtyre dokumenteve, komunat detyrohen që çdo vit të aprovojnë në kuvendin komunal planin për transparencë. Ky plan ndër tjera duhet të rregullojë edhe çështjet e monitorimit dhe zbatimit të akteve që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike dhe prokurimit.<sup>13</sup>

<sup>8</sup> Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 45, Burimi:

<http://bit.ly/2h3BfRE>

<sup>9</sup> Më shumë rreth buxhetit të qytetarëve mund të lexoni në faqën e International Budget Partnership: <http://bit.ly/2vpQsni>

<sup>10</sup> Ligji nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale, Neni 68, Burimi: <http://bit.ly/2f6Yuh4>

<sup>11</sup> Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 61.2

<sup>12</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Neni 6


<sup>13</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Neni 11

## Njohuritë dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e buxhetit

Për të matur njohuritë e qytetarëve lidhur me buxhetin lokal, Instituti GAP ka kryer një hulumtim në 38 komuna të Kosovës duke përdorur metodën sasiore të hulumtimeve.<sup>14</sup> Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1,000 qytetarë të Kosovës, të moshës mbi 18 vjeç – 750 shqiptarë, 150 serbë dhe 100 pjesëtarë të komuniteteve të tjera. Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Anketimi është realizuar nga UBO Consulting nga data 14 deri më 25 janar 2017.

Sipas këtij hulumtimi të Institutit GAP, një e treta (1/3) e qytetarëve të Kosovës kanë mungesë të njohurive bazë lidhur me burimet e të hyrave vetanake të komunave. Për shembull, rreth 33% mendojnë se tatimi në të ardhurat personale kontribuon direkt në të hyrat e komunës, ndërsa 22% e qytetarëve mendonin se trusti pensional kontribuon po ashtu.<sup>15</sup> Niveli i ulët i informatave sa i përket të hyrave komunale, mund të shpjegojë pjesërisht nivelin e ulët të të hyrave vetanake të realizuara nga komunat.

**FIGURA 1:** CILAT PAGESA TË QYTETARËVE KONTRIBUOJNË DIREKT NË RRITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS?



Nëse shohim përgjigjet e të anketuarve në bazë të nivelit të edukimit, shohim se qytetarët me nivel më të lartë të edukimit, baçelor ose më shumë, janë më të informuar sa i përket burimeve të të hyrave komunale. Gjithashtu, qytetarët që jetojnë në zona urbane (74%) janë më të informuar se tatimi në pronë përbën të hyra direkte në buxhetin e komunës krahasuar me ata që jetojnë në zona rurale (67%). Mirëpo nuk është vërejtur ndonjë dallim i madh sa i përket nivelit të informacionit se lejet e ndërtimit janë të hyra vetanake të komunave. Sa i përket etnisë, shqiptarët janë më të informuar se lejet për ndërtim përbëjnë të hyra vetanake të komunës (84%), krahasuar me minoritetet tjera etnike (72%). Së fundmi, edhe gjinia luan rol në nivelin e informimit, duke qenë së në dyja pyetjet një


<sup>14</sup> Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e "mostrës së shtresuar të rastit", ku popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që njihen si shtresa, bazuar në karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave.

<sup>15</sup> Instituti GAP, Rezultate të papublikuara nga një hulumtim i kryer me 1,000 qytetarë në 38 komuna të Kosovës

përqindje më e lartë e burrave kanë qenë më të informuar sa i përket të hyrave vetanake të komunave.

Sipas një raporti të MAPL-së, në vitin 2016 në vetëm 45% të rasteve kuvendet komunale e kanë konsultuar publikun gjatë miratimit të akteve komunale, ndërsa sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe buxhetit komunal, publiku është konsultuar në 96% të rasteve. Në anën tjetër, në bazë të hulumtimit të Institutit GAP, vetëm 52% e qytetarëve janë të informuar se komunat kanë për detyrë të organizojnë dëgjime buxhetore lidhur me buxhetin e komunës, ndërsa 81% e qytetarëve kanë deklaruar së në 12 muajt e fundit nuk kanë marr asnjëherë pjesë në ndonjë tubim publik të organizuar nga komuna.<sup>16</sup> Arsye për mospjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime publike është mungesa e interesimit dhe besimit se sugjerimet e tyre do të merren parasysh.<sup>17</sup>

**FIGURA 2:** KUSH E KA PËR DETYRË TË ORGANIZOJË DËGJIME BUXHETORE ME QYTETARË LIDHUR ME BUXHETIN?



Në përgjigjet e anketuesve në bazë të gjinisë, shohim se burrat (56%) janë më të informuar se komuna duhet të organizojë dëgjime buxhetore, krahasuar me gratë (47%). Sa i përket nivelit të edukimit, 63% e atyre me nivel baçelor e kanë informatën e lartpërmendur, krahasuar me rreth 50% të atyre me shkollim të mesëm. Nëse marrim parasysh moshën, 61% e të anketuarve mbi 55 vjeç kanë informacion se komuna e ka për detyrë të organizojë dëgjime buxhetore, krahasuar me vetëm 48% të atyre të moshës 18-24. Së fundmi, personat të cilët informohen nga radio ose televizione lokale, janë më të informuar lidhur me detyrimin e komunave për të organizuar dëgjime buxhetore, krahasuar me ata që informohen nga televizione apo radio nacionale.

## Indeksi i transparencës buxhetore komunale

Rezultatet e indeksit tregojnë një nivel mesatar të transparencës buxhetore të komunave. Nga 34 komuna të vlerësuara, afro gjysma e tyre kanë mbledhur mbi 50 pikë në indeks.<sup>18</sup> Sidoqoftë, shqetësues mbetet fakti që 21 komuna (62%) nuk kanë publikuar në ueb-faqet e tyre, ose nuk kanë ofruar dokumente zyrtare pas kërkesës së dorëzuar nga Instituti GAP, një apo më shumë dokumente të cilat janë të

<sup>16</sup> Instituti GAP, Rezultate të papublikuara nga një hulumtim i kryer me 1,000 qytetarë në 38 komuna të Kosovës

<sup>17</sup> Instituti Riinvest, Punim Udhëzues - Transparenca Buxhetore dhe Buxheti i Qytetarëve, Burimi: <http://bit.ly/2vAE59L>

<sup>18</sup> Siç u përmend më lartë pjesë e indeksit nuk janë komuna e Ferizajt, Klinës, Gjakovës dhe ajo e Hanit të Elezit pasi që të njejtave nuk u punon ueb-faqja.

detyruara t'i publikojnë dhe bëjnë të qasshme për qytetarët. Në shumicën e rasteve, këto komuna nuk kanë publikuar ndonjërin prej raporteve financiare tremujore, raportin përmbledhës të buxhetit të vitit 2016 dhe në raste më të rralla ndonjë dokument tjetër.

Tri komunat me performancën më të mirë në Indeksin e Institutit GAP për transparencën buxhetore janë komuna e Istogut me 86 pikë, Prizrenit me 77.5 pikë dhe ajo e Drenasit me 75.5 pikë (Figura 1). Komuna e Istogut ka numrin më të madh të dokumenteve të publikuara në formatin MS Excel, që lejon përdorim të lehtë të të dhënave të buxhetit nga qytetarët. Ndërsa, Komuna e Prizrenit është e vetmja komunë e cila i ka të publikuara online të gjitha dokumentet që e përbëjnë indeksin në fjalë. Por, përkundër kësaj, Prizreni renditet i dyti pasi që formati në të cilin janë të publikuara dokumentet (PDF) merr më pak pikë, siç edhe sqaron pjesa e metodologjisë më lartë. Përderisa, Komuna e Drenasit nga dokumentet të cilat është e detyruar t'i publikojë, nuk ka të publikuar në ueb-faqe vetëm buxhetin e planifikuar për vitin 2017. Mirëpo, të njëjtin dokument dhe dokumentet tjera të kërkuara nga ne, Drenasi na i ka dërguar përmes postës elektronike.

Ndërsa, tri komunat e renditura si të fundit në indeksin e transparencës buxhetore lokale, nga komunat të cilat kanë mbledhur të paktën një pikë në këtë indeks, janë Novobërda me 7.5 pikë, Parteshi me 17.5 pikë dhe Klokoti me 20 pikë (Figura 1). Këto komuna, nga dokumentet e përfshira në indeks nuk kanë publikuar më shumë se tri dokumente.

Komuna e Novobërdës ka publikuar dy raporte financiare, raportin e tremujorit të parë dhe të dytë për vitin 2016 në format të skanuar dhe rregulloren për ndarjen e bursave, por jo edhe atë për ndarjen e subvencioneve. Përveç një pjese të madhe të dokumenteve të papublikuara nga Komuna e Novobërdës, në ueb faqe të komunës nuk ka pas asnjë lajmërim apo njoftim për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017. Komuna e Parteshit prej raporteve ka publikuar vetëm Raportin vjetor financiar për vitin 2016 në formatin e skanuar dhe rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Ndërsa sa i përket dëgjimeve buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017, Komuna e Parteshit në ueb faqe të saj zyrtare ka njoftuar për një dëgjim të mbajtur buxhetor. Kurse, Komuna e Klokotit ka publikuar vetëm Kornizën afatmesme buxhetore 2017-2019 në formatin e skanuar, ndërsa ka njoftuar për tri dëgjime të mbajtura buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017.


Kurse, komunat sikurse ajo e Leposaviqit, Zubin Potokut, Mitrovicës Veriore dhe Zveçanit kanë zero pikë pasi që nuk kanë të publikuar asnjë dokument në ueb-faqet e tyre, që janë kryesisht jo funksionale, dhe nuk na kanë dërguar asnjë nga dokumentet që ua kemi kërkuar përmes kërkesës.<sup>19</sup>

Sa i përket dokumenteve të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara mbi buxhetin mirëpo që komunat nuk janë të obliguara t'i publikojnë, sikurse "Kartela Analitike e Kontos", ato janë vështirë të qasshme nga qytetarët. Vetëm komuna e Prizrenit e ka të publikuar kartelën analitike të kontos, dhe atë me të dhëna të pjeshme, ndërsa përmes kërkesës këtë dokument na e kanë dërguar vetëm komuna e Deçanit, Drenasit, Istogut, Kaçanikut dhe Vitisë. Ndërsa, sa i përket listave të

<sup>19</sup> Sa për krahasim, që të katër komunat e larguara nga indeksi, Ferizaj, Gjakova, Hani i Elezit dhe Klina, na kanë dërguar shumicën e dokumenteve të kërkuara përmes postës elektronike përkundër që ueb-faqja e tyre është jo funksionale.

përfituesve të subvencioneve, rreth 33% e komunave nuk i kanë të publikuara në ueb-faqe apo nuk na i kanë dërguar ato përmes kërkesës. Për më shumë, ka raste kur listat e publikuara në ueb-faqe janë vetëm të ndonjërës prej drejtorive, sikurse nga ajo e arsimit për përfituesit e bursave.


**FIGURA 3: INDEKSI PËR TRANSPARENÇË BUXHETORE KOMUNALE**



Për përpilimin e Indeksit për transparencë buxhetore komunale janë analizuar gjithsej 285 dokumente. Nga to, 35% janë në formatin MS Excel, 21% në PDF, 30% në formatin e skanuar dhe 14% të dërguara përmes kërkesës. Dy komunat me numrin më të madh të dokumenteve në ueb-faqe në formatin MS Excel janë Istogu (77%) dhe Gjilani (77%). Ndërsa, komunat që na kanë dërguar më së shumti dokumente pas parashtrimit të kërkesës janë Mamusha (62%), Deçani (46%), Obiliqi (46%) dhe Shtërpca (46%) (Figura 2).



**FIGURA 4:** KOMUNAT ME PËRQINDJEN MË TË MADHE TË DOKUMENTEVE TË PUBLIKUARA NË UEB-FAQE SI MS EXCEL DHE ATO ME PËRQINDJEN MË TË MADHE TË DOKUMENTEVE TË DËRGUARA SIPAS KËRKESËS



Raporti vjetor financiar për vitin 2016 është dokumenti të cilin numri më i madh i komunave e kanë bërë të qasshëm. Të dhënat tjera rreth dokumenteve përbërëse të indeksit tregojnë se gjithsej 25 komuna kanë publikuar në ueb-faqet e tyre apo kanë dërguar sipas kërkesës raportin financiar të tremujorit të parë, dhe po ashtu 25 komuna kanë publikuar në ueb-faqet e tyre apo kanë dërguar sipas kërkesës raportin financiar të tremujorit të dytë. Ndërkaq, vërehet një transparencë e mirë e komunave në publikimin e listave të përfituesve të subvencioneve ku 67% e tyre i kanë bërë të qasshme ato lista. Sa i përket dëgjimeve buxhetore, në vitin 2016 janë mbajtur gjithsej 87 sosh (Tabela 1). Janë vetëm shtatë komuna të cilat nuk kanë prezantuar njoftime në ueb-faqe për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore apo që nuk janë përgjigjur sipas kërkesës tonë.<sup>20</sup>

<sup>20</sup> Tre nëse nuk numërojmë komunat të cilat nuk kanë prezantuar njoftime në ueb-faqe apo nuk na janë përgjigjur në kërkesë

**TABELA 2:** STATISTIKA RRETH DOKUMENTEVE PJESË TË INDEKSIT

↑	Excel	PDF	Skanu	Kërkesë	Numri i Komunave
	Numri i dokumenteve				
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	6	10	4	25
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	7	9	4	25
Raporti financiar TM 3 për vitin 2017	8	6	5	4	23
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	7	5	10	5	27
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	7	7	5	5	24
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	3	6	11	2	22
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	2	3	17	1	23
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	2	6	8	7	23
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2016	0	1	0	5	6
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017	61	14	12	4	91 dëgjime b.

## Përfundime dhe rekomandime

Në këtë raport është analizuar legjislacioni sa i përket transparencës buxhetore në nivel lokal në Kosovë dhe është bërë një vlerësim i gjendjes lidhur me nivelin e transparencës buxhetore në nivel lokal. Në bazë të indeksit tonë, komunat kanë një nivel mesatar sa i përket transparencës buxhetore. Megjithatë, është shqetësuese se gjatë hulumtimit tonë nuk kemi mundur të kemi qasje në një numër të dokumenteve buxhetore, e të cilat dokumente me aktet ligjore në fuqi komunat obligohen t'i publikojnë në faqet zyrtare të internetit.

Legjislacioni aktual rregullon bazën sa i përket kërkesave për publikimin e dokumenteve kyçe në procesin e buxhetit dhe organizimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë. Mirëpo, jo të gjitha komunat i respektojnë këto kërkesa ligjore sa i përket publikimit të dokumenteve apo respektimit të Ligjit për qasje në dokumente publike. Në shumicën e ueb-faqeve të komunave dokumentet rreth buxhetit janë vështirë të qasshme dhe nuk janë të kategorizuara sipas fushave. Ka raste kur, për shembull, Korniza Afatmesme Buxhetore vendoset vetëm në vendimet e kuvendit komunal apo kur dokumentet tjera rreth buxhetit vendosen tek kategoria e raporteve dhe jo tek kategoria e buxhetit apo pasqyrave financiare. Në raste të rralla, dokumentet buxhetore gjenden vetëm në faqen e drejtorisë komunale të financave

Baza ligjore do të duhej të avancohej me kërkesa shtesë të cilat kërkojnë publikimin e dokumenteve më të detajuara të të hyrave dhe shpenzimeve si dhe në format të lexueshëm nga kompjuteri (*machine readable*). Nga 285 dokumente, pjesë e indeksit, 31% janë në formatin e skanuar. Kjo paraqet një përqindje të lartë të dokumenteve që janë vështirë të përdorshme për qëllime studimi nga organizatat joqeveritare dhe studiues të pavarur për analizimin e buxhetit.

Legjislacioni aktual gjithashtu siguron një bazë minimale ligjore sa i përket organizimit të dëgjimeve buxhetore. Mirëpo, sipas të gjeturave tona, pjesëmarrja e përgjithshme e qytetarëve në këto dëgjime është shumë e ulët. Arsye për këtë janë mungesa e njohurive të qytetarëve rreth buxhetit si dhe mungesa e besimit në institucione. Thuajse të gjitha komunat nuk paraqesin në ueb-faqet e tyre procesverbale rreth dëgjimeve buxhetore të mbajtura me qytetarë. Përveç tjerash, procesverbalet e tilla do të ishin dëshmi se sa adresohen sugjerimet e qytetarëve në planifikimin e buxhetit. Si rrjedhojë, kjo do të ndikonte edhe në pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në dëgjime buxhetore në të ardhmen. Arsye tjetër mund të jetë edhe mungesa e buxheteve për qytetarë si dhe një strategji të komunave për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto dëgjime.

Duke marr parasysh këto të gjetura, Instituti GAP rekomandon:

- Me qëllim të rritjes së transparencës dhe përfshirjes së akterëve relevant në procesin e buxhetit, MAPL dhe MF:
  - duhet të avancojnë bazën ligjore për transparencë që të kërkohej nga komunat t'i publikojnë të gjitha dokumentet në format excel. Një shembull i mirë i publikimit të disa raporteve buxhetore në excel është Komuna e Prishtinës me platformën "Prishtina Open Data". Shih vegzën për më shumë: <http://bit.ly/2j5qweJ>;

- të kërkojnë nga komunat që t'i bëjnë publike Kartelat Analitike të Kontos;
- Në mënyrë që të rritet përfshirja dhe besimi i qytetarëve me proceset buxhetore:
  - Komunat duhet t'i publikojnë të gjitha dokumentet buxhetore, procesverbalet dhe materialet përcjellëse nga dëgjimet buxhetore lidhur me kërkesat e qytetarëve;
  - LMFPP duhet të plotësohet në mënyrë që organizatat buxhetore të hartojnë buxhetet për qytetarë të cilat përmbajnë informata të thjeshtëzuara dhe të vizualizuara për buxhetin;
  - Me qëllim të lehtësimit të gjetjes së informatës nga qytetarët, vegëzat e dokumenteve të publikuara në ueb-faqen e komunave duhet të vendosen në bazë të fushave.
- Në mënyrë që të rritet transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në buxhetim, LMFPP duhet të përcaktojë qartë se Zyrtari/ja Kryesor Financiar dhe kryetari/ja i/e komunës duhet të organizojnë takime buxhetore me qytetarë;
- Komunat duhet të bëjnë më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve. Disa nga mekanizmat që komunat mund të vënë në zbatim për të zgjuar interesimin e qytetarëve që të marrin pjesë në procesin buxhetor janë: fokus grupet, takimet në komunitet, stimulimet buxhetore, formimi i komisioneve këshillëdhënëse të qytetarëve për buxhet, anketat me qytetarë, platformat online, etj.<sup>21</sup>

---

<sup>21</sup> Për më shumë shih analizën e Institutit GAP dhe Grupit për Studime Politike dhe Juridike, Burimi: <http://bit.ly/2y0HuNf>

## Anekset

### Komuna e Istogut

**Rangimi në indeksin e transparencës:** **1**

**Numri i pikëve:** **86/100**

Në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, del se Komuna e Istogut është komuna më transparente. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Po ashtu, Komuna e Istogut ka të publikuara dy lista të përfituesve të subvencioneve komunale, njëra nga to në 'PDF' dhe tjetra është e skanuar, çfarë e bënë shumë më të vështirë përdorimin e këtyre informacioneve nga qytetarët. Komuna e Istogut nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore, por është përgjigjur pozitivisht në kërkesën për të lejuar qasje në këtë dokument. Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione, konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT

Dokumenti	Pikët			
	Excel	PDF	Skenuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	-	-	-
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	-	-	-
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	-	-	-
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	15	-	-	-
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	-	-	-
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	10	-	-	-
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	5	-
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	3.5	2.5	-
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	10
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>65</b>	<b>3.5</b>	<b>7.5</b>	<b>10</b>

**86**

## Komuna e Prizrenit

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**2**

**Numri i pikëve:**

**77.5/100**

Në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, Komuna e Prizrenit hynë në kuartilin e katërt<sup>22</sup> që në indeks kanë prej 57 pikë e më shumë. Të gjitha dokumentet buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'PDF', i cili lejon qasje në të dhëna të publikuara por është më i vështirë për përdorim të tyre. Komuna e Prizrenit në raportin vjetor financiar për vitin 2016 ka përfshirë lista të përfituesve të subvencioneve të ndara sipas drejtorive komunale dhe detaje të ngjashme të Kartelës Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore. Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione, konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	-	10.5	-	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	-	3.5	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	7	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	5	-	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	7	-	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	14	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	-	5	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	-	5	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	-	5	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	-	5	-	-	
<b>Totali</b>	-	<b>77.5</b>	-	-	<b>77.5</b>

<sup>22</sup> Kuartili i parë = kuartili i ulët; Kuartili i dytë = kuartili i mesëm i ulët; Kuartili i tretë = kuartili i mesëm i lartë; Kuartili i katërt = kuartili i lartë.

## Komuna e Drenasit

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**3**

**Numri i pikëve:**

**75.5/100**

Komuna e Drenasit në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, bënë pjesë në kuartilin e katërt të komunave që në indeks kanë 57 pikë e më shumë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Komuna e Drenasit nuk ka të publikuara lista të përfituesve të subvencioneve komunale, por është përgjigjur pozitivisht në kërkesën tonë për të lejuar qasje në këtë dokument, por edhe për dokumente si: rregulloren për ndarjen e subvencioneve, buxhetin e planifikuar për vitin 2017 dhe Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË DRENASIT

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	-	-	2.5	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	15	-	-	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	-	-	-	1.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	10	-	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	-	1.5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	-	-	5	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	10	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>55</b>	<b>-</b>	<b>2.5</b>	<b>18</b>	<b>75.5</b>

## Komuna e Lipjanit

**Rangimi në indeksin e transparencës:****4****Numri i pikëve:****72.25/100**

Në bazë të Indeksit për transparencë buxhetore të komunave, Komuna e Lipjanit gjendet në kuartilin e katërt që ka marrë 72.25 pikë nga 100 pikë sa është totali i indeksit. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të kësaj komune në internet dhe janë në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Po ashtu, Komuna e Lipjanit ka të publikuara lista të përfituesve të subvencioneve komunale, pjesa më e madhe e tyre janë në 'PDF', ndërsa pagesat për përfituesit individual në bujqësi është publikuar në formatin 'Excel'. Komuna e Lipjanit nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	-	-	2.5	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	15	-	-	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	-	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	7	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	5	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	2.5	5.25	-	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>52.5</b>	<b>12.25</b>	<b>7.5</b>	<b>-</b>	<b>72.25</b>



## Komuna e Kamenicës

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**5**

**Numri i pikëve:**

**65/100**

Komuna e Kamenicës në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave hynë në kuartilin e katërt të komunave që në indeks kanë mbledh 57 pikë apo shumë pikë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara, por raporti vjetor financiar për 2016 dhe buxheti i planifikuar për vitin 2017 janë publikuar si dokumente të skanuara, çfarë e bënë shumë të vështirë përdorimin informacioneve që përmbajnë këto dokumente nga qytetarët. Po ashtu, Komuna e Kamenicës ka të publikuara lista të përfituesve të subvencioneve komunale si dokumente të skanuara, ndërsa nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuara	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	-	-	7.5	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	-	-	2.5	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	10	-	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	5	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	-	5	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>45</b>	<b>-</b>	<b>20</b>	<b>-</b>	<b>65</b>

## Komuna e Gjilanit

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**6**

**Numri i pikëve:**

**60/100**

Komuna e Gjilanit në bazë të Indeksit për transparencë buxhetore të komunave hynë në kuartilin e katërt të komunave që në indeks kanë mbledh 57 pikë apo shumë pikë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'Excel', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Komuna e Gjilanit nuk ka të publikuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019, listën e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016 dhe Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore. Për dy dokumentet e fundit Komuna e Gjilanit ka kërkuar të specifikohet kërkesa për shkak të materialeve voluminoze, por që me pas nuk kemi marrë përgjigjen në kërkesën tonë.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË GJILANIT

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skenuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	15	-	-	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	-	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	-	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	-	-	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	-	-	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>60</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>60</b>

## Komuna e Kaçanikut

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**7**

**Numri i pikëve:**

**58.16/100**

Në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, Komuna e Kaçanikut hynë në grupin e komunave që bëjnë pjesë në kuartilin e katërt dhe kanë 57 pikë apo më shumë në indeks. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formatin 'PDF' dhe të skanuara, çfarë e bënë shumë më të vështirë përdorimin e këtyre informacioneve nga qytetarët. Po ashtu, Komuna e Kaçanikut ka të publikuara lista të përfituesve të subvencioneve komunale, njëra nga to në 'PDF' dhe dy të tjera janë të skanuara. Komuna e Kaçanikut nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore, por është përgjigjur pozitivisht në kërkesën për të lejuar qasje në këtë dokument. Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione, konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	-	-	2.5	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	-	-	7.5	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	-	3.5	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	7	-	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	5	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	2.31	3.35	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	10	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	-	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>19.81</b>	<b>18.35</b>	<b>10</b>	<b>58.16</b>

## Komuna e Malishevës

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**8**

**Numri i pikëve:**

**56/100**

Komuna e Malishevës në bazë të Indeksit për transparencë buxhetore të komunave është pjesë e kuartil të tretë, që në indeks kanë prej 56 pikë ose më pak. Një pjesë e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe janë në formate të ndryshme më së shumti dokumente publikohen të skanuara por edhe në formatin 'Excel' dhe 'PDF', kjo formë e publikimit të raporteve bënë shumë të vështirë përdorimin e këtyre informacioneve nga qytetarët. Komuna e Kaçanikut nuk ka të publikuara lista të përfituesve të subvencioneve komunale, por është përgjigjur pozitivisht në kërkesën për të lejuar qasje në këto dokumente. Nga Komuna Malishevës nuk publikohet as Kartela analitike të kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skenuar	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	-	-	2.5	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	-	-	2.5	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	-	-	7.5	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	-	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	-	5	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	-	-	5	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	-	-	5	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>25</b>	<b>3.5</b>	<b>22.5</b>	<b>5</b>	<b>56</b>

## Komuna e Shtimës

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**9**

**Numri i pikëve:**

**56/100**

Në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave, ka dal se Komuna e Shtimes hynë në kuartilin e tretë të komunave që në indeks kanë prej 56 pikë e më pak. Një pjesë e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në formatin 'Excel', 'PDF' dhe të skanuara. Publikimi i dokumenteve si të skanuara e bënë shumë të vështirë përdorimin e informacioneve që përmbajnë këto dokumente. Po ashtu, Komuna e Shtimes ka të publikuara listë të përfituesve të subvencioneve komunale, në formatin 'PDF' i skanuar, dhe Rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Komuna e Shtimes nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

**TABELA:** VLERËSIMI I DETAJUAR PËR TË GJITHA DOKUMENTET BUXHETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES

Dokumenti	Pikët				
	Excel	PDF	Skanuara	Kërkesa	
Raporti financiar TM 1 për vitin 2016	-	3.5	-	-	
Raporti financiar TM 2 për vitin 2016	5	-	-	-	
Raporti financiar TM 3 për vitin 2016	-	-	-	-	
Raporti vjetor financiar për vitin 2016	-	-	7.5	-	
Buxheti i planifikuar për vitin 2017	5	-	-	-	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019	-	-	5	-	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	-	-	-	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2016	-	-	5	-	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për 2016	-	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (1)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (2)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (3)	5	-	-	-	
Dëgjimet buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2017 (4)	5	-	-	-	
<b>Totali</b>	<b>35</b>	<b>3.5</b>	<b>17.5</b>	<b>-</b>	<b>56</b>

## Komuna e Vushtrrisë

**Rangimi në indeksin e transparencës:**

**10**

**Numri i pikëve:**

**54.5/100**

